



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 23 janar 2017

NJOFTIM

DISKUTIM PUBLIK

Draft Rregulla për Skemën Mbështetëse dhe Draft Rregulla për të Hyrat e OST/OT-së

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), si pjesë e amandamentimit të legjislacionit sekondar pas hyrjes në fuqi të ligjeve të reja të energjisë, ka publikuar për diskutim publik në faqen elektronike të saj www.ero-ks.org, **Draft Rregullën për Skemën Mbështetëse të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë dhe Draft Rregullën për vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale (HLM) të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT).**

Rregulla për Skemën Mbështetëse ka për qëllim përkrahjen e prodhimit të energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), në mënyrë që të arrihen caqet e përcaktuara për këto burime. Gjithashtu Rregulla përcakton kriteret dhe procedurën për aplikim dhe pranim në Skemën Mbështetëse me qëllim të përkrahjes së prodhimit të energjisë nga BRE-të.

Rregulla për të Hyrat e OST/OT vendosë bazën për vlerësimin e HLM që OST-OT mund të përfitojë në një vit përkatës, në mënyrë që të mbulojë kostot e arsyeshme të zhvillimit, operimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të transmetimit. Gjithashtu përcakton procesin sipas të cilit të hyrat e lejuara maksimale do të shqyrtohen dhe do të ripërcaktohen periodikisht si dhe përcakton procesin sipas të cilit caktohen taksat për kyçje dhe tarifatat për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit (SHST), tarifatat e OS dhe ato të OT, prej të cilave do të mbliidhen HLM-të.

ZRRE fton të gjitha palët e interesuara që të dërgojnë komentet e tyre në lidhje me këto rregulla, deri me 6 shkurt 2017, në adresën elektronike info@ero-ks.org. Ose në adresën postare Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë